



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
PROJEKTLIGJ
Nr. ____/2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9049, DATË 10.4.2003
“PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE
FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË” TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 pika 4, pika 8 dhe pika 9 ndryshohen si më poshtë:

“4. “Person i lidhur me një zyrtar” ka kuptimin e përcaktuar në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

8. Termat “konflikt i interesit”, “zyrtar”, “person i lidhur”, “interesa privatë”, të përdorur në këtë ligj, kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

9. Përkufizimet “të dhënat personale” dhe “përpunimi i të dhënave” kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 2

Në Nenin 3/1, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kandidatët për pozicionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, që janë subjekte që mbartin detyrimin për deklarimin e interesave privatë, sipas parashikimeve të nenit 3, të këtij ligji, nuk kryejnë një deklaram të ri, por i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë. Nëse gjatë 180 ditëve para paraqitjes së kërkesës, kandidati është kontrolluar nga Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer”.

Neni 3

Në nenin 4/2 pika 1 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Të gjitha subjektet e ligjit dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklaram, detyrohen të plotësojnë deklaratën e tyre në formë elektronike me mjetet e komunikimit elektronik, të vëna në dispozicion nga Inspektorati i Lartë dhe ta paraqesin personalisht, në formë fizike, të mbyllur në zarf në strukturat përkatëse të institucioneve, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj për të gjitha llojet e deklaramit.

“3. Deklarata e dërguar me mjete të komunikimit elektronik konsiderohet e marrë me plotësimin dhe dërgimin në sistemin e deklaramit me mjetet elektronike”.

Neni 4

Në Nenin 26, paragrafi 4 ndryshohet si më poshtë:

“Me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm apo inspektorëve të autorizuar prej tij, bankat e nivelit të dytë dhe subjektet e tjera, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, detyrohen të japin të dhëna për depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga personat që, sipas këtij ligji, kanë detyrimin për deklaram”.

Neni 5

Në nenin 42/1 pikat 3, 4, 5 ndryshohen si më poshtë:

“3. Për efekt të deklaramit të dërguar me mjete të komunikimit elektronik, sipas nenit 4/2 të ligjit, zbatimi i tij kryhet me përgatitjen dhe vënien në dispozicion të infrastrukturës së nevojshme nga Inspektorati i Lartë. Deri në momentin e funksionimit të sistemit elektronik, subjektet e këtij ligji dhe personat e lidhur mbartin detyrimin për të paraqitur deklaratën e interesave privatë, në formë fizike dhe të mbyllur në zarf, në strukturat përkatëse të institucioneve.

4. Për efekt të sigurimit të të dhënave dhe informacionit, sipas nenit 26 të ligjit, zbatimi i tij kryhet me përgatitjen dhe vënien në dispozicion të infrastrukturës së nevojshme nga Inspektorati i Lartë.

5. Për efekt të publikimit të deklaratave të interesave privatë, sipas nenit 34/2 të ligjit, zbatimi i tij kryhet me përgatitjen dhe vënien në funksionim të infrastrukturës së nevojshme nga Inspektorati i Lartë.”

Neni 6

Pas nenin 42/1 shtohet neni 42/2 me përmbajtjen si më poshtë:

“1. Për efekt të deklarimit të interesave private të dërguar me mjete të komunikimit elektronik, sipas nenit 4/2 të ligjit, të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrimin për deklarim, detyrohen të deklarojnë:

- a) Në deklarimin periodik vjetor, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në 31 dhjetor të vitit të deklarimit.
- b) Në deklarimin para fillimit të punës, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë private të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit.
- c) Në deklarimin pas largimit nga funksioni, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë private të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në datën e largimit nga funksioni.

2. Parashikimet në gërmat a) dhe c) janë të vlefshme vetëm për plotësimin për herë të parë të deklaratës së interesave private nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

3. Inspektori i Përgjithshëm, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj pike”.

Neni 7

Hyrja në Fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI